



## **Oferta 1: Kushtet**

### **Kushtet e plota për të gjithë zotëruesit e kartave**

Avis-i po u ofron një zbritje prej 10% të gjithë zotëruesve të ligjshëm të kartave standarde në Evropë, përfshirë Rusinë, Turqinë dhe Bashkësinë e Shteteve të Pavarura. Kjo zbritje nuk aplikohet për personat që zotërojnë një kartë premium Mastercard.

Kjo ofertë është e vlefshme kur zotëruesit e një karte standard Mastercard plotësojnë kërkesat e tyre në panelin e rezervimit kryesor direkt në faqen e rezervimeve të Avis-it, duke përdorur kodin AWD U193700. Zbritja do të aplikohet automatikisht në momentin kur vëhet rezervimi. Rezervimi duhet të bëhet të paktën 24 orë para.

Ulja prej 10% është e vlefshme për të gjitha rezervimet për qira që bëhen dhe plotësohen mes periudhës 19 Prill 2022 deri më 30 Shtator, 2022. Qiraja duhet të përfundojë përpara datës 16 Dhjetor 2022.

Uljet bëhen sipas normës standarde të Avis-it.

Kjo ulje do të jetë e vlefshme për të gjitha veprimet globale dhe varion sipas disponueshmërisë dhe kohës së vitit.

Oferta mund të mos jetë e shoqëruar me ndonjë ulje tjetër, promovim ose ofertë, në varësi të disponueshmërisë.

Avis pranon kartat e kreditit Mastercard dhe në disa vende kartat e debitit Mastercard. Avis nuk pranon kartat me parapagim edhe në rastet kur ato kanë logon Mastercard.

Lutemi, sigurohuni që kur bëni rezervime, të përdorni kartën Mastercard, me qëllim që të aplikohet ulja e saktë.

Oferta është e vlefshme për të gjitha grupet e makinave, në varësi të disponueshmërisë në kohën kur bëhet rezervimi.

Në vende të caktuara dhe në raste të veçanta mund të përdoren kufizimet e ofertës. Çmimet e qirasë mund të variojnë sipas sezonit ose sipas vendit ku operon Avis.

Do të zbatohen kushtet dhe afatet standarde të Avis-it.